



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë e Huaj C (Nivel i avancuar 1)

Ngarkesa: 4 kredite; 60 orë mësimore; 0 leksione / 60 orë ushtrime
Viti / Semestri : Viti I , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i shkencave në “Mësuesi gjuhën Itallane”
Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda **Gjuhë e huaj C (niveli i avancuar 1)** i drejtohet studentëve të vitit të parë Master i Shkencave (FGJH, UT), të cilët e zgjedhin atë si gjuhë të dytë në semestrin e parë. Lënda i shërben mësimin të gjuhës së huaj në nivel të avancuar gjuhësor. Për këtë studenti duhet të ketë përfutur njohuri të gjuhës italiane në nivel B2. Ky kurs mundëson gjithashtu përvetësimin dhe thellimin e dijeve në lidhje me strukturat dhe leksikun e disa tipologjive të gjuhëve specialistike. Parashikon perfeksionimin e kompetencave gjuhësore të avancuara dhe në të njëjtën kohë mundëson familjarizimin e studentit me akspekte të italishtes sektoriale..

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

- 1.Të shprehur rrjedhshëm në gjuhën italiane.
- 2.Të jetë në gjendje të bisedojë dhe të shkëmbejë mendime në lidhje me tema të caktuara të nivelit akademik
- 3.Të lexojë dhe përkthejë tekste të ndryshme qoftë letrare apo artikuj gazetaresh, si edhe materiale të tjera me përmbajtje specialistike

Rezultatet e pritshme:

- 1.Studenti zotëron aftësi të avancuara në të folur dhe të shkruar në gjuhën italiane (niveli C1), duke u shprehur me rrjedhshmëri, saktësi gjuhësore dhe fleksibilitet stilistik për tema të përgjithshme dhe akademike.
- 2.Studenti është në gjendje të lexojë, përkthejë dhe analizojë tekste të ndryshme (letrare, publicistike, akademike dhe specialistike), si dhe të përmbledhë dhe interpretojë përmbajtjen e tyre duke përdorur frazeologji të përshtatshme në italisht.